

VENDIM
Nr.21, datë 12.3.2008

PËR TËRHEQJEN NGA QARKULLIMI TË DISA KARTËMONEDHAVE
ME KURS LIGJOR

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, gërma “b”, të nenit 40, pika 5, të nenit 43, gërmat “c” dhe “d” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të kreut II të udhëzimit “Për hedhjen në qarkullim të prerjeve të reja të kartëmonedhave dhe monedhave kombëtare e për tërheqjen nga qarkullimi të parasë”, miratuar me vendimin nr.27, datë 30.3.1998 të Këshillit Mbikëqyrës; të kreut II, pika 5 të rregullores “Për funksionimin e Departamentit të Emisionit”, të miratuar me vendimin nr.21, datë 28.3.2001 të Këshillit Mbikëqyrës, të ndryshuar; dhe me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave me kurs ligjor si më poshtë:
 - a) Kartëmonedha prerje 100 lekë, emetim i viteve 1993, 1994, 1996, imazhi i Luftëtarit Kombëtar.
 - b) Kartëmonedha prerje 100 lekë, emetim i vitit 1996, imazhi i Fan S.Nolit.
 - c) Kartëmonedha prerje 200 lekë, emetim i viteve 1992, 1994, 1996, imazhi i Ismail Qemalit.
 2. Kartëmonedhat me prerjet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi do të kenë kurs ligjor deri në datën 31.12.2008.
 3. Kartëmonedhat me prerjet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi do të mblidhen për këmbim kundrejt pagesës së vlerës fillestare të emetimit me kartëmonedha dhe monedha të tjera në qarkullim, deri në datën 31.12.2010.
 4. Ngarkohen të gjitha bankat, degët e bankave të huaja dhe zyrat e këmbimit valutor të pranojnë për këmbim, deri në datën 31.12.2010, kartëmonedhat me prerjet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi dhe t’i dërgojnë ato pranë Bankës së Shqipërisë dhe degëve të saja.
 5. Ngarkohen Departamenti i Emisionit dhe Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës të Bankës së Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.
 6. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, si dhe të shpallë njoftimin zyrtar të Bankës së Shqipërisë në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani